

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
E.D FURNITURE SHPK**

Ne Tirane, sot me date 02.03 2021

1. **Z. Eduart Huta**, shtetas shqiptar, i biri i Shkelqimit, lindur me 07/04/1994, ne ZallHerr Tirane, dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar nepermjet kartes se identitetit me Nr. 034301510 dhe nr. personal J40407113F,

Te hartoj kete Akt Themelimi te shoqerise **E.D FURNITURE SHPK** mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:

KREU 1

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **E.D FURNITURE SHPK**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit(QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.


Shoqëria **E.D FURNITURE SHPK**, eshte nje shoqeri, që themelohet ndërmjet ortakeve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, **ne Rrugen "Teodor Keko",Njesia Tregtare Nr.5,ne katin nentoke,zona kadastrate 3866, pasuria nr.35,Yzberisht, ,Tirane.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.



Neni 4
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte: Veprimtari ne fushen e mobilerise, perfshin: prodhim mobiljesh, perpunim druri, shitje -tregtim , sherbim projektimi per arredim ambjentesh te brendshme si dhe/ose pjesemarrja ne çdo veprim ose aktivitet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, apo çdo veprimtari ne lidhje me to, dhe çdo aktivitet ekonomik qe do te konsiderohet i nevojshem dhe i dobishem ne menyre qe te permbushet qellimi i veprimtarise, dhe qe nuk bie ne kundërshtim me legjislacionin Shqiptar.

Neni 5
Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise **E.D FURNITURE SHPK** eshte e pakufizuar.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000lekë (njemije leke).

- a) Ortaku **Eduart Huta** eshte zoterues i 1(nje) kuote me vlere nominale 1.000 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7
Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej



tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

1. a)kontributit në kapitalin e shoqërisë;
b)shitblerjes;
c)trashëgimisë;
ç)dhurimit;
d)çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
4. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8


Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;



i) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion financiar kreditor.

j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga **Z. Eduart Huta**, shtetas shqiptar, i biri i Shkelqimit, lindur me 07/04/1994, ne ZallHerr Tirane, dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar nepermjet kartes se identitetit me Nr. 034301510 dhe nr. personal J40407113F sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjecare me te drejte ripërteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;


ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punës, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këto statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13
Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nën parim nga Ortaket të shoqërisë tregtare **E.D FURNITURE SHPK**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË
E.D FURNITURE SHPK

Eduart Huta

